



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF**  
**KOSOVO**

**Komuna e Kaçanikut**

Opština Kačanik/Municipality of Kačanik  
Zyra e Kryetarit



**05-400/03-12323**

**Kaçanik, 17.06.2026**

Procesverbal nga Konsultimi buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2027–2029 me qytetarë të Komunës së Kaçanikut

**Vendi:** Salla e Kuvendit Komunal

**Ora:** 14:00

**Data:** 09.06.2026

Komuna e Kaçanikut, përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, e cila ka hartuar Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe nenin 6, pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, organizoi konsultim publik për këtë dokument të rëndësishëm planifikues.

Fillimisht, drejtori për Buxhet dhe Financa Valdrin Dogani, prezantoi draftin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029. Ai theksoi se Korniza Afatmesme Buxhetore paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2027.

Drejtori Dogani bëri të ditur se buxheti për vitin e ardhshëm parashikohet të jetë mbi 14 milionë euro, i cili do të shpërndahet në të gjitha kategoritë buxhetore të shpenzimeve, në përputhje me prioritetet dhe nevojat e qytetarëve.

Në takim prezantoi edhe Kryetari i Komunës Sabedin Vishi, i cili inkurajoi qytetarët që të bëhen pjesë e dëgjimeve dhe konsultimeve publike, duke theksuar se vendimmarrja bëhet më reale dhe më gjithëpërfshirëse kur qytetarët kontribuojnë me idetë dhe kërkesat e tyre.

Kryetari Vishi prezantoi ndarjet e planifikuara në kategoritë financiare, duke u ndalur veçanërisht te investimet kapitale. Ai përmendi investimet në administratë, bashkëfinancimin e projekteve, ku së shpejti pritet të realizohet në partneritet me një organizatë projekti për ndërtimin e fabrikës së ujit, si dhe bashkëfinancimin e projekteve të tjera. Po ashtu, ai prezantoi investimet e planifikuara në shërbimet publike dhe hapësirat publike, rrugë, kanalizim dhe ujësjellës, e strehimore për qentë endacak, bujqësi përmes rregullimit të kanaleve të ujitjes dhe rrugëve fushore, zhvillimin ekonomik përmes krijimit të hapësirave rekreative, si dhe investimet në shëndetësi, përfshirë ndërtimin e parkingut nëntokësor pranë QKMF-së. Investime janë

planifikuar edhe në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, përmes ndërtimit të terreneve sportive dhe organizimit të aktiviteteve kulturore, si dhe në arsim, përmes digjitalizimit të shkollave dhe përmirësimit të infrastrukturës shkollore.

Nga ana tjetër, të pranishmit në konsultimin publik, kryesisht përfaqësues të fshatrave dhe lagjeve urbane, paraqitën kërkesat dhe nevojat e komuniteteve që përfaqësojnë.

**Kadri Dardhishta-** Të vendosen shenja orientuese të rrugës Llanishtë dhe Dërnagllavë, si dhe rregullim i terreneve sportive.

**Kujtim Luma-** Në fshatin Glloboqicë të rregullohet rruga për te xhamia, rregullimi i parkingut afër xhamisë dhe shenjëzimi i rrugëve.

**Hasip Salihu-** Disa rrugë në Bajincë janë të dëmtuara dhe kërkojnë trajtim, rregullimi i rrugës për Semajë, ndriçim i rrugëve, rregullimi i fushës së sportit dhe terreneve sportive.

**Fatmir Luta-** Të rregullohet rruga në Ivajë dhe rregullimi i mureve mbrojtëse.

**Besnik Dema-** Të rregullohet trotuari te shkolla, në lagjen Kukaj të bëhet ndriçimi publik, të bëhet destinimi për përdorim i objektit të ambulantës si dhe të zgjidhet problemi me qentë endacak.

Për të gjitha kërkesat u diskutuan dhe u dhanë përgjigje edhe nga drejtori i Arsimit dhe stafi përcjellës, ndërsa në vazhdim do të përgatitet edhe raporti me detaje për secilën kërkesë të parashtruar.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi

Zyrtare e Lartë për Komunikim

